



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05- 91
Podujevë,
20.03.2019

Bazuar në nenin 28,paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/1-138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12,paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës,dhe në bazë të Rregullores (MASHT) nr. 01/2017, e datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur, Drejtoria e Arsimit, shpall :

Konkurs

Për regjistrimin e vijuesve të rritur në Arsimin e mesëm të lartë profesional klasa X

SHMLT “ Fan S. Noli “

Profilet

- informatikë
- telekomunikacion
- postë dhe telekomunikacion
- energjetikë
- instalues elektrikë
- trafik rrugor
- ndërtimtari
- automekanik
- instalues i ngrohjes dhe klimatizimit
- saldator
- arkitekturë
- rrobaqepësi

SHMLE “ Isa Boletini “

Profilet

- kontabilitet
- administrim biznesi

- banka dhe sigurime
- asistent juridik

Kushtet

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimit për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, i datës 30.12.2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 dhe UA 12/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë kaluar moshën për të genë nxënës të rregullt.

Dokumentet e nevojshme për regjistrim

- Dëftesat e klasave të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011. Për participimin e vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur, Rregullores për të hyra vetanake të institucioneve arsimore të komunës së Podujevës nr. 01/148-350, i datës 29.04.2010.

Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur :

a) për regjistrim të vitit për një klasë.....	100,00 €
b) për praktikë profesionale.....	50,00 €
c) për provim diferencial.....	10,00 €
d) provimi përfundimtar /certifikata - diploma.....	50,00 €

Pagesat bëhen në institucionet përkatëse edukativo-arsimore sipas kodeve të shkollave.

Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin do t'iu nënshtrohen provimeve diferenciale bazuar në Udhëzimin administrativ të MASHT-it nr. 16/2011, i datës 30.12.2011.

Kandidatët të cilët ndërrojnë drejtimin janë të obliguar që paraprakisht t'iu nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.

Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë nga vijimi i klasës për të cilën kandidati është paraqitur për regjistrim.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin " Arsimit dhe aftësimi për të rritur " janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

drejtori
Agim Blakçori

